



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1.1, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Ligji nr. 03/L-229, (Gazeta zyrtare nr. 88, dt. 25.11.2010) si dhe neni 4 dhe 7A, paragrafi 2 i Plotësim Ndryshimit të Ligjit 04/L-226 Komisioni i Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me **dt. 21.11.2017** nxjerr këtë:

## **UDHZËZIM ADMINISTRATIV NR.06/2017**

### **PËR PËRJASHTIMIN GRUPOR TË MARRËVESHJES PËR DISTRIBUIMIN DHE SERVISIMIN E AUTOMJETEVE MOTORIKE**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### *Qëllimi i Udhezimit Administrativ*

##### Neni 1

Me këtë udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet që duhet të përmbajnë marrëveshjet për distribuimin dhe servisimin e automjeteve motorike dhe kufizimet ose kushtet të cilat këto marrëveshje nuk mund të përmbajnë për t'u përjashtuar bashkërisht nga ndalimi i përgjithshëm në nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji).

##### *Përkufizimet*

##### Neni 2

Për qëllimet e këtij udhëzimi administrativ, shprehjet e caktuara kanë kuptimin e mëposhtëm:

a) *marrëveshje vertikale në sektorin e distribuimit dhe servisimit të automjeteve motorike* është një kontratë, dispozitë e caktuar e kontratës, marrëveshje me gojë ose me shkrim dhe një praktikë e bashkërenduar që rezulton nga marrëveshje të tilla, vendim nga një ndërmarrës ose shoqatë ndërmarrësish, kushtet e përgjithshme të afarizmit dhe akte të tjera të ndërmarrësve që janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e kontratës dhe të ngjashme, të lidhura ndërmjet ndërmarrësve që nuk operojnë në të njëjtin nivel të prodhimit, ose distribuimit dhe me të cilën rregullohen kushtet në të cilat palët në marrëveshje mund të blejnë, shesin ose rishesin automjete motorike të reja, pjesë rezervë për automjete motorike ose ofrojnë shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje të automjeteve motorike;

b) *kufizimi vertikal* është kufizimi i konkurrencës që përmbahet në marrëveshjen vertikale për distribuimin dhe servisimin e automjeteve motorike i cili është i përfshirë në nenin 4 paragrafi 1.1-1.5 të Ligjit;

- c) *Ndërmarrje është* qdo aktivitet biznesor pavarsisht menyres se organizimit ose formes se menaxhimit, nderremarresi publik e themeluar per kryerjen e aktiviteteve per interes publik si dhe qdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetror qe kryen aktivitet ekonomik pavarsisht se a konsiderohet apo Jo subjekt afarist nga neni 3 par.1.7 (i Ligjit);
- e) *Produkt është* një shprehje juridiko-teknike për mallrat dhe/ose shërbimet;
- f) *produkt zëvendësues (zëvendësim)* është një produkt që, duke pasur parasysh tiparet thelbësore të tij, çmimin ose mënyrën e përdorimit, ose shprehitë e konsumatorëve, mund të zëvendësojë një produkt tjetër (legjitim) dhe kështu të plotësojë nevojën ekuivalente të blerësit dhe/ose konsumatorit;
- g) *Distributor i autorizuar i automjeteve motorike të reja* është një distributor që vepron brenda sistemit të vendosur nga furnizuesi i automjeteve motorike të reja;
- h) *Distributor i autorizuar i pjesëve rezervë për automjete motorike* është një distributor që vepron në kuadër të sistemit të distribuimit të vendosur nga furnizuesi i automjeteve motorike;
- i) *distributor i pavarur* është distributor i pjesëve rezervë për automjete motorike që nuk operojnë brenda sistemit të distribuimit të vendosur nga furnizuesi i këtyre automjeteve motorike dhe një distributor i autorizuar brenda sistemit të distribuimit të një furnizuesi të veçantë të automjeteve motorike, në masën në të cilën ai kryen distribuimin e pjesëve rezervë për automjetet motorike të cilat nuk janë të mbuluara nga sistemi i distribuimit së furnizuesit në fjalë;
- j) *Servisues i autorizuar* është një ofrues i shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve motorike që operon brenda sistemit të distribuimit të vendosur nga furnizuesi i automjeteve motorike;
- k) *Servisues i pavarur* është një ofrues i shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve motorike që nuk operon brenda sistemit të distribuimit të vendosur nga furnizuesi i automjeteve motorike për të cilat ai ofron shërbime riparimi ose mirëmbajtjeje. Servisues i autorizuar brenda sistemit të distribuimit së një furnizuesi të caktuar do të konsiderohet si një servisues i pavarur, për qëllimet e këtij udhezimi Administrativ, në masën që ai gjithashtu ofron shërbime riparimi ose mirëmbajtjeje për automjetet motorike që nuk mbulohen nga sistemi distribues i furnizuesit në fjalë;
- l) *pjesët rezervë* janë mallra që duhet të montohen në një automjet motorik, me qëllim të zëvendësimit të pjesëve të atij automjeti, duke përfshirë mallrat, si lubrifikantë, të cilat janë të domosdoshëm për përdorimin e një automjeti motorik, me përjashtim të karburantit;
- m) *tregu relevant/përkatës* - fushën e tregtisë për të cilën konkurrenca është kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme për të cilat konsumatorët mund të drejtohen në afat sa më të shkurtër, në rast se kufizimi apo abuzimi rezulton në ngritjen e çmimit;

### *Marrëveshjet për të cilat zbatohet përjashtimi grupor*

#### Neni 3

(1) Përjashtimet grupore zbatohen për marrëveshjet vertikale në sektorin e distribuimit dhe servisimit të automjeteve motorike të referuara nga neni 6, I ligjit dhe nenit 7A te plotsim ndryshimit te ligjit nr.04/L226, në lidhje me kushtet në të cilat palët kontraktuese mund të blejnë,

shesin ose rishesin automjete motorike të reja, pjesë rezervë për automjete motorike ose ofrojnë shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje për automjetet motorike, veçanërisht për marrëveshjet që:

a) zbatojnë një sistem cilësor ose sistem të përzier cilësor-sasior selektiv të distribuimit si një formë shpërndarjeje dhe/ose servisimi të automjeteve motorike,

b) zbatojnë distribuimin ekskluziv ose furnizimin ekskluziv si një formë distribuimi dhe/ose servisimi të automjeteve motorike,

c) përmbajnë dispozita që i caktojnë ose japin blerësit në përdorim të drejtën e pronësisë intelektuale, me kusht që këto dispozita të mos përbëjnë qëllimin kryesor të marrëveshjeve të tilla dhe të jenë të lidhura drejtpërsëdrejti me përdorimin, shitjen dhe/ose rishitjen e produkteve të cilat janë objekt i një marrëveshjeje të tillë nga ana e blerësit ose blerësve të tij.

(2) Përjashtimet grupore zbatohen në mënyrë të jashtëzakonshme, nën kushtet e përcaktuara në nenin 7 të këtij Udhezimi Administrativ dhe në disa marrëveshje vertikale të lidhura ndërmjet shoqatave të interesit të ndërmarrësve dhe anëtarëve të këtyre shoqatave, si dhe midis të këtyre shoqatave dhe furnizuesve të tyre ose marrëveshje të caktuara vertikale të lidhura mes konkurrentëve.

(3) Automjetet motorike të reja të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni janë automjete motorike vetëlëvizëse të destinuara për përdorim në rrugë publike, me tre ose më shumë rrota dhe si të tilla konsiderohen automjetet personale, automjetet e pasagjerëve, automjetet e lehta komerciale, autobusët dhe kamionët.

(4) Sistemi selektiv i distribuimit i referuar në paragrafin 1, pika a) të këtij neni, është një sistem i distribuimit i vendosur mbi bazën e një marrëveshjeje mbi distribuimin dhe servisimin e automjeteve motorike në të cilat furnizuesi merr përsipër të shesë direkt ose indirekt produktet që janë objekt i marrëveshjes, vetëm për distributorët ose servisuesit e përzgjedhur në bazë të kriterëve të veçanta dhe transparente dhe distributorët ose ofruesit e shërbimeve marrin përsipër të mos i shesin prodhimet e tilla distributorëve të paautorizuar ose servisuesve të pavarur, duke mos përjashtuar mundësinë e shitjes së pjesëve rezervë për servisuesit e pavarur ose detyrimin për të ofruar të gjitha informacionet teknike, pajisjet diagnostike, veglat dhe trajnimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve motorike operatorëve të pavarur, ose me qëllim të zbatimit të masave për mbrojtjen e mjedisit.

(5) Një sistem cilësor selektiv i distribuimit është sistemi i referuar në paragrafin 4 të këtij neni, në të cilin furnizuesi përcakton kriteret për përzgjedhjen e distributorëve ose servisuesve që janë ekskluzivisht të natyrës cilësore. Kriteret të tilla janë të nevojshme për shkak të natyrës së produkteve që janë objekt i marrëveshjes dhe janë vendosur në mënyrë unike për të gjithë distributorët ose servisuesit që dëshirojnë të bashkohen në këtë sistem distribuimi dhe nuk duhet të zbatohen në mënyrë diskriminuese dhe nuk mund të kufizojnë drejtpërdrejt numrin e distributorëve apo servisuesve në tregun përkatës.

(6) Sistemi i përzier i distribuimit selektiv cilësor-sasior, është sistemi i referuar në paragrafin 4 të këtij neni, në të cilin furnizuesi përcakton kriteret për zgjedhjen e një distributori ose servisuesi me të cilat kufizon drejtpërsëdrejti numrin e tyre në tregun përkatës.

(7) Marrëveshja që zbaton distribuimin ekskluziv si formë e distribuimit dhe servisimit të automjeteve motorike nga paragrafi 1 pika b) të këtij neni, është një marrëveshje vertikale me të cilën furnizuesi është i detyruar të shesë produktet që janë objekt i një marrëveshjeje vetëm për një distributor të vetëm të zgjedhur në një zonë të caktuar ose tek një grup blerësish që i është caktuar ekskluzivisht atij distributori.

(8) Marrëveshja që zbaton furnizimin ekskluziv si një formë e distribuimit dhe servisimit të automjeteve motorike nga paragrafi 1 pika b) të këtij neni është një marrëveshje vertikale me të cilën furnizuesi drejtpërdrejt ose tërthorazi merr përsipër të shesë produktet të cilët janë objekt i marrëveshjes, vetëm tek një blerës në tregun e Republikës së Kosovës me qëllim të përdorimit specifik ose shitjes së mëtejshme.

(9) Nuk lejohet në të njëjtin treg përkatës nëpërmjet një marrëveshjeje për distribuimin dhe servisimin e automjeteve motorike, përdorimi i një sistemi selektiv të distribuimit të përmendur në paragrafin 1 pika a) dhe paragrafët 4, 5 dhe 6 të këtij neni, në formën e distribuimit ekskluziv ose furnizimit ekskluziv nga paragrafi 1 pika b) dhe paragrafët 7 dhe 8 të këtij neni.

(10) Tregu perkates i referuar në paragrafin 9 të këtij neni nënkupton tregun për distribuimin e automjeteve motorike të reja, tregun për distribuimin e pjesëve rezervë për automjetet motorike dhe tregun për ofrimin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve motorike.

#### *Marrëveshjet për të cilat nuk zbatohet përjashtimi grupore*

##### Neni 4

Sipas këtij Udhezimi Administrativ, nuk mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm i përmendur në nenin 4 paragrafi 1 i Ligjit:

(a) Marrëveshjet vertikale në sektorin e distribuimit dhe servisimit të automjeteve motorike që nuk janë në përputhje me këtë Udhezim Administrativ;

(b) Marrëveshjet vertikale në të cilat zbatohen vetëm udhëzimet administrative të tjera të përjashtimit grupor të përmendura në nenin 6 dhe 7a paragrafi 2 të Ligjit.

## **II. KUSHTET TË CILAT MARRËVESHJET PËR DISTRIBUTUIMIN E AUTOMJETEVE MOTORIKE TË REJA DUHET TË PËRMBAJNË**

#### *Pjesëmarrja në treg*

##### Neni 5

(1) Përjashtimet grupore për marrëveshjet vertikale për distribuimin e automjeteve motorike të reja duhet të zbatohen me kusht që pjesëmarrja në treg e furnizuesit në tregun përkatës për shitjen e automjeteve motorike të reja nuk është më shumë se 30% ose 40% nëse me marrëveshje krijohet një sistem i përzier selektiv i distribuimit cilësor-sasior për shitjen e automjeteve motorike të reja.

(2) Përjashtimisht, niveli i pjesës së tregut nuk do të merret parasysh si kusht për përjashtimet grupore të marrëveshjeve vertikale në sektorin e distribuimit të automjeteve të reja motorike, nëse furnizuesi i automjeteve të reja motorike ka krijuar një sistem cilësor të distribuimit selektiv.

(3) Nëse marrëveshja për distribuimin e automjeteve të reja motorike parashikon një detyrim ekskluziv të furnizimit, përjashtimi grupor nga ky Udhezim Administrativ zbatohet me kusht që pjesëmarrja në treg e blerësit, në tregun përkatës në të cilin blenë automjetet të reja motorike të cilat janë objekt i marrëveshjes, nuk është më shumë se 30%.

### *Llogaritja e pjesëmarrjes në treg*

#### Neni 6

(1) Pjesëmarrja në treg në tregun përkatës, sipas kuptimit të nenit 5 paragraf 1 i këtij Udhezimi Administrativ, për distribuimin e automjeteve të reja motorike, do të llogaritet në bazë të sasisë së produkteve të shitura nga furnizuesi dhe të cilat janë objekt i marrëveshjes, si dhe produkteve të tjera që konsiderohen si produkte zëvendësuese të tyre.

(2) Pjesëmarrja në treg nga paragrafi 1 i këtij neni rritet për shumën e të hyrave të ndërmarrësve të lidhur furnizues të cilën ata e kanë realizuar në treg të produkteve që janë objekt i marrëveshjes dhe produkteve zëvendësues të tyre.

(3) Të hyrat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni zvogëlohen për shumën e detyrimit doganor, tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimet e tjera të cilat janë direkt të lidhura me qarkullimin dhe rabatet në vitin financiar që i paraprin lidhjes së marrëveshjes.

(4) Pjesëmarrja në treg e blerësit në tregun përkatës në të cilin blenë produktet që i nënshtrohen një marrëveshjeje e cila nuk është më e lartë se 30% dhe është përcaktuar si kusht për aplikimin e përjashtimit grupor nëse marrëveshja parashikon një detyrim të furnizimit ekskluziv, brenda kuptimit të nenit 5 paragrafi 3 të këtij Udhezimi Administrativ, do të llogaritet në mënyrë të përshtatshme, duke zbatuar kriteret nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni në vlerën e furnizimit të blerësit ose në vlerësimin e kësaj vlere.

(5) Nëse shuma e të hyrave është e panjohur, për përcaktimin e pjesëmarrjes në treg të ndërmarrësit mund të përdoren edhe të dhënat e tjera të tregut në dispozicion, duke përfshirë sasinë e produkteve të shitura në treg, përveç nëse ndërmarrësi nuk ka kryer aktivitete në tregun përkatës në vitin financiar para lidhjes së një marrëveshjeje.

(6) Nëse pjesëmarrja në treg e një ndërmarrësi në kohën e lidhjes së një marrëveshjeje nuk është më shumë se 30% ose 40% në rast se me marrëveshje krijohet një sistem i përzier cilësor-sasior i distribuimit selektiv për shitjen e automjeteve të reja motorike, dhe më pas rritet mbi atë shumë, jo më shumë se 35% ose 45% në rast se me marrëveshje krijohet një sistem i përzier cilësor-sasior i distribuimit selektiv për shitjen e automjeteve të reja motorike, përjashtimi grupor do të zbatohet gjatë një periudhe prej dy vitesh të njëpasnjëshme kalendarike pas vitit në të cilin për herë të parë është rritur shuma e pjesëmarrjes në treg më shumë se 30%, ose më shumë se 40%.

(7) Nëse pjesëmarrja në treg në kohën e lidhjes së një marrëveshjeje nuk është më shumë se 30% ose 40% në rast se me marrëveshje krijohet një sistem i përzier cilësor-sasior i distribuimit selektiv për shitjen e automjeteve të reja motorike, por më pas rritet në më shumë se 35% ose më shumë se 45% në rast se me marrëveshje krijohet një sistem i përzier cilësor-sasior i distribuimit selektiv për shitjen e automjeteve të reja motorike, përjashtimi grupore do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë njëvjeçare kalendarike pas vitit në të cilin pjesëmarrja në treg është rritur për herë të parë mbi 35% ose mbi 45%.

(8) Përjashtimi nga paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni nuk mund të përmbliidhet për qëllimet e zgjatjes së periudhës kohore të përjashtimit grupor në më shumë se dy vite kalendarike.

*Totali i të hyrave vjetore për marrëveshje të caktuara vertikale për distribuimin e automjeteve të reja motorike*

Neni 7

(1) Përjashtimet grupore zbatohen gjithashtu edhe për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet shoqatave të ndermarrjeve dhe anëtarëve të shoqatave, si dhe ndërmjet shoqatave të tilla dhe furnizuesve të tyre:

a) nëse të gjithë anëtarët e këtyre shoqatave janë distributorë të automjeteve të reja motorike,

b) Nëse asnjë anëtar i këtyre shoqatave, së bashku me ndërmarrësit e tij të lidhur, nuk ka të hyra vjetore më të mëdha se (500,000.00 – 1,000,000.00) milionë euro.

(2) Përjashtimet grupore zbatohen gjithashtu për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet ndërmarrësve që konkurrojnë me njëri-tjetrin, me kusht që marrëveshja të mos garantojë të drejta dhe detyrime të barabarta për secilën prej palëve:

a) nëse furnizuesi është gjithashtu prodhuesi dhe distributori i automjeteve të reja motorike dhe blerësi shpërndan, por nuk prodhon produkte zëvendësuese,

b) nëse furnizuesi është ofrues i shërbimeve në disa nivele tregtare dhe blerësi nuk ofron shërbime zëvendësuese në nivel tregtar ku blen shërbimet që janë objekt i marrëveshjes,

c) Nëse blerësi ka të hyrat vjetore Jo më të mëdha se 500,000.00 – 1,000,000.00 milionë euro.

*Llogaritja e të hyrave vjetore totale*

Neni 8

(1) Për qëllimet e nenit 7 të këtij udhezimi administrativ, të hyrat vjetore totale llogariten si të hyra totale vjetore që një ndërmarrës ka krijuar gjatë vitit financiar para lidhjes së një marrëveshjeje të cilave janë shtuar të hyrat totale vjetore të ndërmarrësve të lidhur me të.

(2) Të hyrat e përgjithshme vjetore nga shitja e produkteve ndërmjet ndërmarrësve dhe ndërmarrësve të tyre të lidhur dhe shitjes së produkteve ndërmjet ndërmarrësve të lidhur nuk do të merren parasysh gjatë llogaritjes së të hyrat totale vjetore nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Të hyrat totale vjetore të llogaritura në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni zvogëlohen për shumën e detyrimeve doganore, tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimet tjera që lidhen drejtpërsëdrejti me qarkullimin dhe rabatat.

(4) Përjashtimi grupor për marrëveshjet e përmendura në nenin 7 të këtij udhezimi administrativ vazhdojnë të zbatohen edhe nëse gjatë një periudhe prej Dy viteve të njëpasnjëshme financiare, shumata e të hyrave totale vjetore rritet për jo më shumë se 10%.

*Kohëzgjatja, ndërprerja, zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe transferimi i të drejtave dhe detyrimeve sipas marrëveshjes për distribuimin e automjeteve të reja motorike tek palët e treta*

Neni 9

(1) Përjashtimi grupor zbatohet me kusht që marrëveshja vertikale, e cila është lidhur nga furnizuesi i automjeteve të reja me distributorin e automjeteve të reja motorike, rregullon:

a) lidhjen e një marrëveshjeje për një periudhë prej së paku pesë vjetësh dhe secila palë e marrëveshjes merr përsipër të njoftojë palën tjetër së paku gjashtë muaj përpara për qëllimin e saj për të mos rinovuar marrëveshjen,

b) lidhjen e një marrëveshjeje për një periudhë të pacaktuar, me ç'rast afati për njoftimin e anulimit të një marrëveshjeje për të dy palët e marrëveshjes duhet të jetë së paku dy vjet përpara anulimit të synuar dhe kjo periudhë mund të reduktohet në të paktën një vit, kur:

- një ligj ose një marrëveshje e veçantë e detyron furnizuesin të paguajë një tarifë përkatëse për anulim të marrëveshjes,

- furnizuesi anulon marrëveshjen, sepse është e nevojshme të riorganizohet rrjeti i tërë ose një pjesë e rëndësishme e rrjetit.

(2) Një përjashtim grupore zbatohet me kusht që në një marrëveshje vertikale të lidhur me distributorin e automjeteve të reja motorike, është rregulluar që furnizuesi i cili dëshiron të ndërpresë marrëveshjen duhet ta bëjë këtë me shkrim dhe në mënyrë të tillë që ai të paraqesë arsye të hollësishme, objektive dhe transparente për ndërprerjen e marrëveshjes, në mënyrë që furnizuesi të pengohet të ndërpresë një marrëveshje vertikale me distributorin e automjeteve të reja motorike për shkak të veprimeve që, në përputhje me këtë udhëzim administrativ, nuk mund të jenë të kufizuara.

(3) Një përjashtim grupor zbatohet me kusht që marrëveshja vertikale për distribuimin e automjeteve të reja motorike siguron të drejtën e secilës prej palëve në marrëveshje për të zgjidhur mospajtimet që dalin nga marrëveshja nëpërmjet Tribunalit të përhershëm të arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës pa përjashtuar të drejtën e secilës palë që mosmarrëveshjet të zgjidhen nëpërmjet gjykatës.

(4) Një përjashtim grupor zbatohet me kusht që, në marrëveshjen vertikale të lidhur me distributorin e automjeteve të reja motorike, është rregulluar që furnizuesi pajtohet me transferimin e së drejtës dhe detyrimeve nga marrëveshja vertikale për distribuimin e

automjeteve të reja motorike te një distributor tjetër i automjeteve të reja brenda sistemit të njëjtë të distribuimit, të zgjedhur nga një distributor i cili transferon të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje.

### III. KUFIZIMET, RESPEKTIVISHT KUSHTET TË CILAT MARRËVESHJET PËR DISTRIBUIMIN E AUTOMJETEVE TË REJA MOTORIKE NUK MUND TË PËRMBAJNË

*Kufizime serioze mbi konkurrencën e tregut në marrëveshjet për distribuimin e automjeteve të reja motorike*

#### Neni 10

(1) Përjashtimi grupor i parashikuar në këtë Udhezim Administrativ nuk mund të zbatohet për marrëveshjet vertikale në lidhje me shitjen e automjeteve të reja motorike, të cilat direkt ose indirekt, vetëm ose së bashku me faktorë të tjerë të kontrolluar nga palët kontraktuese, përmbajnë kufizime vertikale që konsiderohen si kufizime serioze mbi konkurrencën, të cilat synojnë:

a) kufizimin e të drejtave të distributorëve të automjeteve të reja motorike për të përcaktuar lirisht çmimin e shitjes së produktit, që nuk përjashton furnizuesin nga përcaktimi i çmimit maksimal të shitjes ose nga rekomandimi i çmimit të shitjes, me kusht që të mos jetë fiks ose çmime minimale të shitjes që rezultojnë nga presioni ose nxitje nga cilado palë kontraktuese,

b) kufizimin e zonës ku distributori i automjeteve të reja motorike mund të shesë produkte nga marrëveshja ose të kufizojë shitjen e produkteve të kontraktuara të një grupi të caktuar konsumatorësh,

c) kufizimin e anëtarëve brenda sistemit të distribuimit selektiv që operojnë në nivel të shitjes me pakicë, shitjet aktive ose pasive të automjeteve të reja motorike tek përdoruesit përfundimtarë,

(d) kufizimin e furnizimit të ndërsjellë midis distributorëve të automjeteve të reja motorike brenda sistemit selektiv të distribuimit, duke përfshirë kufizimet ndërmjet distributorëve të automjeteve të reja motorike që nuk operojnë në të njëjtin nivel të tregtisë,

e) kufizimin e së drejtës së distribuimit për të shitur çdo automjet të ri motorik që korrespondon me një model të fushës kontraktuale të produktit të përcaktuar nga marrëveshja,

f) kufizimin e së drejtës së distributorit të automjeteve të reja motorike, i cili në të njëjtën kohë është servises i autorizuar i automjeteve motorike, për të deleguar autorizimin për ofrim të shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve motorike për servisesit e tjerë të autorizuar, duke mos përjashtuar të drejtën e furnizuesve të automjeteve të reja motorike për të kërkuar nga ai distributor, para lidhjes së një kontrate shitjeje të një automjeti të ri motorik, ofrimin e informacioneve tek përdoruesit përfundimtarë për emrin dhe adresën e servisit të autorizuar.

(2) Me përjashtim të paragrafit 1 pika (b) të këtij neni, nuk konsiderohen si të ndaluara nga kufizimet vertikale në marrëveshjet që kanë të bëjnë me shitjen e automjeteve të reja, kufizimet e mëposhtme që kanë për qëllim:



a) kufizimi i distributorit të automjeteve të reja të shitjeve aktive në një zonë ekskluzivisht të caktuar ose të një grupi ekskluziv blerës të rezervuar për furnizuesin, ose në zonën ose blerësve që furnitori ka ofruar për shitjen një distributori tjetër të automjeteve të reja motorike, me kusht që kufizimet e tilla të imponuara nga furnizuesi nuk pamundësojnë shitje të mëtejshme nga blerësit e këtyre distributorëve,

b) duke kufizuar distributorin e automjeteve të reja, që veprojnë në nivel të tregut me shumicë, të shfrytëzuesve aktivë dhe pasivë të shitjes,

c) duke kufizuar anëtarët brenda sistemit selektiv të distribuimit së shitjeve aktive dhe pasive të automjeteve të reja distributorëve të paautorizuar në tregjet në të cilët zbatohet sistemi i distribuimit selektiv.

(3) Shitja aktive, në kuptim të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nënkupton kërkim aktiv dhe qasje tek blerësit ose në një grup të caktuar blerësish që gjenden në një territor ekskluziv të një distributori tjetër të mjeteve të reja motorike, lidhjen e kontratave individuale dhe marrjen e masave për ofrimin e produkteve këtyre blerësve, dhe themelimi i degëve, magazinave ose organizimi i rrjeteve të distribuimit dhe reklamimit në territorin ekskluziv të një distributori tjetër të automjeteve të reja motorike. Me një qasje aktive konsiderohet, vizita tek blerësit, dërgimi i postës blerësve, duke përfshirë postën elektronike, publikimet nëpërmjet mediave dhe mjetet e tjera të komunikimit publik të destinuara vetëm për ata blerës ose grupe blerësish në territorin ekskluziv të një distributori tjetër të automjeteve të reja motorike.

(4) Shitjet pasive, brenda kuptimit të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nënkupton përgjigjen e kërkesave të blerësve individualë, përfshirë distribuimin e këtyre produkteve blerësve të tillë, me njoftimin se përgjegjësia e till mund të mos jet pasojë e aktivitetit aktiv të shitjes. Me shitjet pasive përgjithësisht konsiderohen edhe reklamat ose publikimet në media ose në internet, të cilat arrijnë jashtë një territorit ekskluziv të dikujt ose një grupi të caktuar të blerësve, që është rezultat i zhvillimit teknologjik ose thjeshtësisë së qasjes dhe prandaj konsiderohet një mënyrë e arsyeshme për t'u qasur këtyre blerësve ose grupeve të blerësve.

(5) Me vëllimin e produkteve të kontraktuara të përcaktuara me marrëveshje, sipas paragrafit 1 pika e) të këtij neni, konsiderohet të jetë çdo model i ndryshëm i mjetit motorik që një distributor mund të blejë nga një furnizues.

(6) Mjeti motorik që i përgjigjet modelit të fushëveprimit kontraktuar të produktit të përcaktuar me marrëveshjen e përmendur në paragrafin 1 pika (f) të këtij neni, konsiderohet si mjet i lëndës së marrëveshjes për shpërndarjen e automjeteve të reja me një ndërmarrës tjetër brenda sistemit të shpërndarjes të përcaktuar nga prodhuesi i mjeteve të reja motorike i cili është arritur me pëlqimin e tij, dhe cila është:

– prodhuar ose montuar në mënyrë serike nga prodhuesi, dhe

– identike sipas formës, lëvizjes, shasis dhe llojin e motorit të një automjet të caktuar nga modeli siç përcaktohet me marrëveshje.

*Kufizime të tjera serioze të konkurrencës së tregut në marrëveshjet për distribuimin e mjeteve të reja motorike*

Neni 11

(1) Përjashtim grupor nga ky Udhezim Administrativ nuk mund të zbatohet në rastet kur një furnizues i mjeteve të reja motorike i pamundëson ndërmarrjeve të pavarura qasje në informacionin teknik, pajisjet diagnostikuese dhe pajisjet tjera, përfshirë programet përkatëse kompjuterike, ose pamundëson trajnimin e nevojshëm për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të tilla motorike ose për zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit.

(2) Ndërmarrësit e pavarur nga paragrafi 1 i këtij neni do të konsiderohen si ndërmarrës direkt ose indirekt të përfshir në riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike, në veçanti servisues të pavarur, prodhuesve të pajisjeve ose mjeteve për servisimin, distributorëve të pavarur të pjesëve rezervë, ofruesit e informacioneve teknike, auto klubet, operatorët për ndihmë në rrugë, operatorët që ofrojnë shërbimet e kontrollit dhe testimet, dhe operatorët që ofrojnë trajnime për servisues.

*Detyrimet e ndaluara në marrëveshjet për distribuimin e mjeteve të reja motorike*

Neni 12

(1) Një Përjashtim grupor sipas këtij Udhezimi Administrativ nuk mund të zbatohet për marrëveshjet vertikale në lidhje me shitjen e automjeteve të reja motorike që përmbajnë:

a) detyrime direkte ose indirekte të moskonkurrencës,

b) detyrimet direkte ose indirekte të imponuara ndaj anëtarëve të sistemit të distribuimit për të mos i shitur automjete motorike një furnizuesi të caktuar - një konkurrenti të tregut,

c) detyrimet direkte ose indirekte për shkak të cilave distributori i automjeteve të reja motorike nuk mund të prodhojë, blejë, shesë ose distribuoj automjete të reja motorike pas përfundimit të marrëveshjes.

(2) Përjashtimisht nga paragrafit 1 pika (a) të këtij neni, detyrimi për moskonkurrencë nuk konsiderohet i ndaluar nga një kufizim vertikal kur distributori shet automjete të reja motorike të furnizuesve të ndryshëm në hapësira të ndara të sallonit ekspozues, me qëllim të shmangies së konfuzionit. Detyrimi i imponuar ndaj një distributori të automjeteve të reja motorike që për shitjen e një veture personale të një marke tregtare të caktuar, ekziston stafi i posaçëm, konsiderohet e ndaluar me kufizimin vertikal, përveç nëse distributori i automjeteve të reja motorike e vendos atë dhe furnizuesi bartë të gjitha shpenzimet shtesë që lidhen me personelin e veçantë.

(3) Detyrimi i moskonkurrencës në kuptim të paragrafit 1 pika a) dhe paragrafit 2 të këtij neni nënkupton çdo detyrim direkt ose indirekt për të cilin blerësi nuk mund të prodhojë, të shesë ose të rishesë produktet zëvendësuese që konkurrojnë me produktet që janë objekt i marrëveshjes, ose ndonjë detyrim direkt ose indirekt të blerësit për të blerë nga furnizuesi ose nga një ndërmarrës tjetër tek i cili e ka udhëzuar furnizuesi, më shumë se 30 % të sasisë totale të

prodhimit. Kjo pjesë llogaritet në bazë të vlerës së produkteve blerëse dhe produkteve të zëvendësueshme të tyre në tregun përkatës që blerësi e ka fituar në vitin e mëparshëm financiar.

(4) Përjashtim grupor nuk mund të zbatohet për marrëveshjet vertikale në lidhje me shitjen e automjeteve të reja motorike që përmbajnë:

a) detyrime direkte ose indirekte për shkak të cilave një tregtarë që vepron në nivel të tregtisë me pakicë nuk mund të shesë shërbime të lizingut në lidhje me produkte nga marrëveshja ose produktet zëvendësuese,

b) detyrimet e direkte ose indirekte të imponuara distributorit të automjeteve të reja personale dhe/ose automjeteve të lehta të reja komerciale brenda një sistemi selektiv të distribuimit që kufizojnë të drejtën e tij për shitjen ose dërgimin e këtyre automjeteve në lokalet e biznesit në lokacionet tjera në treg ku zbatohet sistemi selektiv i distribuimit.

(5) Automjetet e lehta komerciale nga paragrafi 4 pika (b) të këtij neni janë automjetet e dedikuara për transportin e mallrave ose udhëtarëve, masa e përgjithshme e të cilave nuk i kalon 3.5 tonë dhe nëse një automjet i lehtë komercial shitet në një version me një masë totale më të madhe se 3.5 ton të gjitha versionet e atij automjeti konsiderohet si mjet i lehtë komercial.

#### IV. KUSHTE TË VEÇANTA PËR PËRJASHTIM GRUPOR TË MARRËVESHJEVE VERTIKALE PËR SERVISIMIN E AUTOMJETEVE MOTORIKE

##### Neni 13

Marrëveshjet vertikale për servisimin e automjeteve motorike, me të cilat dakordohen marrëveshjet e shitjes për pjesët rezervë për automjetet motorike dhe marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve motorike të cilat janë përfunduar pas hyrjes në fuqi të këtij udhezimi administrativ, mund të përjashtohen nga ndalesa e përgjithshme në nenin 4 të Ligjit, nëse ato janë tërësisht në përputhje me dispozitat e Udhezimit Administrativ për Përjashtim grupor të Marrëveshjeve Vertikale ndërmjet ndërmarrjeve, dhe nëse ato nuk përmbajnë kufizime serioze të konkurrencës në treg, veçanërisht të caktuara për ato marrëveshje me këtë Udhezim Administrativ.

*Kufizime serioze të konkurrencës së tregut në marrëveshjet që kanë të bëjnë me shitjen e pjesëve rezervë, dhe ofrimin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes për automjetet motorike*

##### Neni 14

(1) Përjashtimi grupor nga ky Udhezim Administrativ nuk mund të zbatohet për marrëveshjet vertikale në lidhje me shitjen e pjesëve rezervë dhe ofrimin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve motorike, të cilat direkt ose indirekt, vetëm ose së bashku me faktorë të tjerë, nën kontrollin e palëve kontraktuese, përmbajnë kufizime vertikale që kanë për qëllim:

(a) kufizimi për anëtarët brenda sistemit të distribuimit selektiv, shitjes së pjesëve rezervë për automjete motorike për servisuesit e pavarur që këto pjesë i shfrytëzojnë për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve motorike;

(b) kufizimin e të drejtave të furnizuesve të pjesëve rezervë, mjeteve të riparimit ose pajisjeve diagnostikuese dhe të tjera, të kontraktuara me prodhuesin e automjeteve motorike për shitjen e pjesëve rezervë, mjeteve të riparimit ose pajisjeve diagnostikuese ose të tjera, shpërndarësve të autorizuar ose të pavarur, përkatësisht servisuesve të autorizuar ose të pavarur ose përdoruesve përfundimtarë;

(c) kufizimin e të drejtave të furnizuesve të pjesëve për mjete motorike, të kontraktuara me prodhuesin e automjeteve motorike i cili i përdor ato pjesë në instalimin e parë në prodhimin e automjeteve motorike, për të shënuar ato pjesë ose pjesë rezervë në formë të duhur dhe vend të dukshëm me emrin e markës ose logon e tyre.

(2) Pjesët rezerve nga paragrafi 1 të këtij neni, janë pjesët që duhet të montohen në automjetin motorik, me qëllim të zëvendësimit të pjesëve të atij automjeti, duke përfshirë mallrat si lubrifikantë të cilat janë të nevojshëm për përdorimin e një automjeti motorik, me përjashtim të karburantit.

(3) Pjesët rezervë, në kuptimin e paragrafit 1 të këtij neni, mund të jenë pjesë rezervë origjinale ose pjesë rezervë me kualitet të njëjtë të krahasueshëm.

(4) Pjesët rezervë origjinale, të referuara në paragrafin 3 të këtij neni, janë pjesë rezervë të cilët janë të kualitetit të njëjtë me ato pjesë që punohen për montimin e një automjeti motorik dhe të cilat prodhohen në përputhje me normat dhe standardet e prodhimit të ofruara nga ana e prodhuesit për prodhimin e pjesëve ose pjesëve rezervë për automjete motorike të përmendura. Kjo përfshin pjesët rezervë që prodhohen në linjën e njëjtë të prodhimit si pjesët. Supozohet se, nëse nuk provohet ndryshe, se pjesët janë pjesë rezervë origjinale nëse prodhuesi i pjesëve konfirmon që pjesët rezervë korrespondojnë me cilësinë e pjesëve të përdorura për montimin e atij automjeti dhe se ato janë prodhuar në përputhje me rregulloret e prodhuesit dhe standardet e prodhimit.

(5) Pjesët rezervë me kualitet të njëjtë të krahasueshëm, të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni janë pjesë rezervë të bëra nga çdo ndërmarrës i cili në çdo kohë mund të konfirmojë se si pjesët e përmendur rezervë janë me kualitet të njëjtë të krahasueshëm me ato të cilat përdoren, ose janë përdorur për montimin e automjeteve motorike.

## V. REVOKIMI I PËRJASHTIMIT GRUPOR

### *Kushtet për revokimit e përjashtimit grupor*

#### Neni 15

(1) Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) mundet sipas detyrës zyrtare, në pajtim me nenin 6 të Ligjit, dhe 7a të plotësimit ndryshimit të ligjit nr. 04/L-226 të inicijet procedurë për vlerësimin e marrëveshjes së veçantë vertikale për distribuimin dhe servisimin e automjeteve motorike, edhe pse kjo marrëveshje i plotëson kushtet për një

përrjashtim grupor sipas ketij Udhezimi Administrativ, në raste kur efektet e kësaj marrëveshjeje, në mënyrë të pavarur ose kumulative, me marrëveshje të ngjashme vertikale në tregun përkatës, nuk i përmbushin kumulativisht, gjatë kohëzgjatjës së tyre, kushtet për përjashtim nga neni 6 të Ligjit, dhe 7a të plotsim ndryshimit të ligjit nr. 04/L-226.

(2) Autoriteti mund të inicojë procesin e vlerësimit të marrëveshjes vertikale për distribuimin dhe servisimin e automjeteve, në kuptim të paragrafit 3 të këtij neni, në veçanti në rastet:

a) kur qasja në treg ose në konkurrencën e tregut është e kufizuar në mënyrë të konsiderueshme nga efekti kumulativ i marrëveshjeve vertikale që kanë kufizime të ngjashme vertikale,

b) kur rrjetet paralele të marrëveshjeve vertikale me kufizime të ngjashme vertikale së bashku mbulojnë më shumë se 50% të tregut përkatës.

(3) Nëse Autoriteti në procesin e vlerësimit të marrëveshjes nga paragrafi 1 të këtij neni përcakton se marrëveshja ka efekte që janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit, dhe 7a të plotsim ndryshimit të ligjit nr. 04/L-226, me vendim do të shfuqizoj përjashtimin grupor për atë marrëveshje.

*Barra e provës për plotësimin e kushteve për përjashtim grupor të marrëveshjeve në sektorin e distribuimit dhe servisimit të automjeteve motorike*

Neni 16

(1) Për marrëveshjet vertikale që rregullojnë distribuimin e mjeteve motorike të reja që plotësojnë kushtet për përjashtim grupor sipas ketij udhezimi administrativ, përkatësisht për marrëveshjet vertikale që rregullojnë distribuimin e pjesëve rezervë dhe shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes të automjeteve motorike, të cilat njëkohësisht i përmbushin kushtet për përjashtim grupor sipas ketij udhezimi administrativ dhe udhezimit administrativ për përjashtim grupor të marrëveshjeve vertikale ndërmjet ndërmarrësve, si rregull, nënkuptohet që i përmbushin kushtet për përjashtim sipas nenit 6 të Ligjit, dhe 7a të plotsim ndryshimit të ligjit nr. 04/L-226, përveç në rastin e referuar në nenin 15 të ketij udhezimi administrative.

(2) Përjashtimisht, për marrëveshjet vertikale që nuk i plotësojnë kushtet për përjashtim grupor nga paragrafi 1 të këtij neni, pjesëmarrësit në marrëveshje të tilla duhet vetë të vlerësojnë nëse marrëveshjet e tyre janë në përputhje me kushtet për përjashtimin nga ndalimi i përgjithshëm i marrëveshjes nga neni 6 të Ligjit, dhe 7a të plotsim ndryshimit të ligjit nr. 04/L-226.

(3) Nëse Autoriteti inicon procedurë për përcaktimin e marrëveshjes së ndaluar nga paragrafi 2 të këtij neni, barra e provës për plotësimin e kërkesave për përjashtim nga neni 6 të Ligjit, dhe 7a të plotsim ndryshimit të ligjit nr. 04/L-226 në atë procedurë, bartet nga ndërmarrësit që marrin pjesë në këtë marrëveshje vertikale për distribuimin dhe servisimin e automjeteve motorike.

## V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 17

#### *Dispozitat kalimtare*

Hasja në vështirësi gjatë aplikimit të dispozitave të këtij udhezimi administrativ apo mungesa e dispozitave për marrjen e vendimit përfundimtar, duhet të aplikohen dispozitat e ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të konkurrencës.

### Neni 18

#### *Ndryshimi dhe plotësimi i Udhezimit Administrativ*

Ndryshimin dhe plotësimin e këtij Udhezimi Administrativ mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

### Neni 19

Përfundimet grupore të marrveshjes për distribuim dhe servisimin e automjeteve motorike duhet të harmonizohen plotësisht me dispozitat e këtij Udhezimi Administrativ

### Neni 20

#### Hyrja në fuqi

Ky Udhezim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

## KOMISIONI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

(\_\_\_\_\_)

Valon Prestreshi

Kryetar

(\_\_\_\_\_)

Ahmet Krasniqi  
Zëvendëskryetar

(\_\_\_\_\_)

Fatime Haziri  
Anëtare

(\_\_\_\_\_)

Muhamet Krasniqi  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)

Shaqir Morina  
Anëtar